



Planuar / Doretuar Punime/Produkt Received/Delivery	07-04-2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	H/Prot Br/Prot Prot.No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMB/SHIK	3446/2023		1/6



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.428/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtari i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.428/2023 të datës 28.02.2023 të parashtruar nga ankuesi _____, të cilin me autorizim e përfaqëson _____ avokat nga Prishtina, kundër Formularit të Vlerësimit të Rezultateve në Punë për vitin 2022 i datës 31.01.2023 të Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 07.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.428/2023 e datës 28.02.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Ndryshohet Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë i datës 31.01.2023 lidhur me notën e përgjithshme të vlerësimit për ankuesin dhe atë nga një pikë shtatë (1.7) bëhet tre (3), "mirë".
- III. Ky vendim zëvendëson Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë për ankuesen si në pikën II të dispozitivit dhe i njëjti duhet të përfshihet në dosjen personale dhe regjistrat përkatës të nëpunësit civil.
- IV. OBLIGOHET Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Kosovës për Administratë Publike që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesi i punësuar në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, më datë 26.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 2146/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit të Vlerësimit të Rezultateve në Punë për vitin 2022 i datës 31.01.2023, me pretendimin ankimor se ankuesi i ka arritur të gjitha objektivat e parapara të punës, sikurse vlerësimi i rezultateve të punës është bërë në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi dhe me aplikim të gabuar të dispozitave procedurale dhe materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.03.2022 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike. Ndërsa, Këshilli më datë 24.3.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës, si dhe me datë 29.03.2023 përmes e-mailit kanë përcjellë prova shtesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 428/2023 të datës 28.08.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e përfaqësuesit të datës 23.02.2023; Aktin e Emërimit të ankuesit me numër:1965 të datës 18.11.2013; Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë për vitin 2022 i datës 31.01.2023; Raportin e të arriturave kryesore për vitin 2022 dhe Objektivat e Planit të Punës për Vitin 2023 i datës 05.01.2023; Raportin e DFSHP-së së Institutit të Kosovës për Administratë Publike, Janar-Dhjetor 2023; Plani i punës për vitin 2022 i datës 18.02.2022; Planin e Punës 01 janar-30 nëntor 2022 për miratimin e projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/l-221 për Institutin e Kosovës për Administratë Publike; Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë për vitin 2019 i datës 20.12.2019; Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë për vitin 2020 i datës 29.01.2021; Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë për vitin periudhën kohore 01 janar-21 qershor 2021 i datës 27.01.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 06.03.2023; E-mailin e datës 29.03.2023 dërguar nga E.H me shkresën përcjellësi e protokolluar me numër: 3096/2023; Përgjigjen në ankesë e datës 24.03.2023 me numër protokoll 2957/2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Administratës në Institutin e Kosovës për Administratë Publike; Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë i datës 31.01.2022 me komentet e ankuesit; Dëshmitë me shkrim lidhur me vërejtjet e dhëna nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë për rritjen e performancës në punë për vitin 2022; Dëshminë-4/1 lidhur me vërejtjet për raportin financiar sipas e-mailit të datës 28.12.2021 dërguar nga E.H për ankuesi me korrespondencën e bashkangjitur prej 11 e-maileve; Dëshminë-4/1 lidhur me vërejtjet për raportin mujor sipas e-mailit të datës 09.11.2022 dërguar nga E.H për ankuesi me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 e-maileve; Dëshminë-4/1 lidhur me vërejtjet për Akademinë e MAPL sipas e-mailit të datës 01.09.2022 dërguar nga E.H për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 e-maileve; Dëshminë-4/1 lidhur me vërejtjet për pakujdesi në artikullim sipas e-mailit të datës 06.12.2022 dërguar nga E.H për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 e-maileve; Dëshmi mbi takimin e apo konsultat që ndërliken me rishikim e progresit lidhur me arritjen e objektiveve; Dëshminë-5/1 ftesa për takime me drejtor sipas e-mailit të datës 14.02.2022 dërguar nga E.H për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 11 e-maileve; Dëshminë-5/2 -10

ftesa për takime ad hoc me drejtor sipas e-mailit të datës 14.02.2022 dërguar nga E.H për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 15 e-maileve; Dëshminë-5/3-10 ftesa për progresin e zbatimit të planit të punës sipas e-mailit të datës 19.10.2022 dërguar nga E.H për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 9 e-maileve; Shkresa e titulluar "Blloku 7"; Shkresat e titulluar "Dëshmi 7/1" me e-mailin e bashkangjitur të datës 29.04.2022 dërguar nga B.Th për E.H me korrespondencën e bashkangjitur; Draft ligji i IKAP plotësuar dhe ndryshuar me datë 08.05.2022; E-mailin e datës 08.05.2022 nga E.H për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur; Draft ligjin për Institutin e Kosovës për Administratë Publike; Shkresën e titulluar "Dëshmi 7/2" lidhur me komentet për Rregulloren për Organizimin e brendshëm të IKAP; Shkresën e titulluar "Dëshmi 7/3" lidhur me urdhrat dhe detyrat e pazbatuara nga ankuesi; E-mailin e datës 09.08.2022 dërguar nga E.H për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 28.09.2022 dërguar nga E.H për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 18.10.2022 dërguar nga E.H për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 21.11.2022 dërguar nga E.H për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 07.12.2022 dërguar nga ankuesi për E.H me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 27.12.2022 dërguar nga ankuesi për E.H me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 faqesh; Shkresën e titulluar "Detyrë/urdhër 8- pazbatuar" me e-mailin e bashkangjitur të datës 13.10.2022 dërguar nga E.H për ankuesin; Shkresën e titulluar "Detyrë/urdhër 8-pazbatuar" me e-mailin e bashkangjitur të datës 01.02.2023 dërguar nga E.H për ankuesin; Shkresën e titulluar "Detyrë/urdhër 9-i pazbatuar" me e-mailin e bashkangjitur të datës 01.02.2023 dërguar nga E.H për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 faqesh; Shkresën e titulluar "Blloku 6" lidhur me raportet e prezantuara të ankuesi gjatë vitit 2022; Raportin për planin mujor të punës i datës 31.01.2022; Raportin për planin mujor të punës i datës 27.04.2022; Raportin për planin e punës të muajit shtator me aktivitetet e bashkangjitura për muajin nëntor; Shkresën e titulluar "Dëshmi 6/2 për Raportin e progresit për zbatimin e planit të punës janar-tetor 2022; E-mailin e datës 20.10.2022 dërguar nga ankuesi për E.H; Shkresën e titulluar "Dëshmi 6/3 për Raportin vjetor të Departamentit për vitin 2022; Raporti i DFSHP-së së Institutit të Kosovës për Administratë Publike për periudhën janar-dhjetor 2022; Raportin mujor të punës për agjencitë i datës 09.02.2022; Raportin mujor të punës për agjencitë i datës 08.03.2022; Raportin mujor të punës për agjencitë i datës 09.02.2022; Raportin mujor të punës për agjencitë i datës 08.04.2022; Raportin mujor të punës për agjencitë i datës 10.05.2022; Raportin mujor të punës për agjencitë i datës 10.06.2022; Raportin mujor të punës për agjencitë i datës 10.07.2022; Raportin mujor të punës për agjencitë i datës 10.08.2022; Raportin mujor të punës për agjencitë i datës 12.09.2022; Raportin mujor të punës për agjencitë i datës 11.10.2022; Raportin mujor të punës për agjencitë i datës 13.11.2022; Raportin mujor të punës për agjencitë i datës 11.01.2023; Raportin mujor të punës për agjencitë i datës 11.01.2023; Raporti Vjetor i performancës për vitin 2021 i datës 20.05.2022; Raporti Vjetor i punës për vitin 2021 i datës 20.04.2022; E-mailin e datës 13.03.2023 dërguar nga Kryetari i Këshillit për anëtarët e Këshillit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës gjegjësisht sipas Akt-it të Emërimit me numër protokolli 1965 të datës 18.11.2013, është konstatuar së ankuesi është i emëruar në pozitën e punës "Drejtor i Departamentit të Administratës", në Institutin e Kosovës për Administratë Publike (në tekstin e mëtejme IKAP), ndërsa i njëjti sipas Formularit të vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022 i

datës 31.01.2023 nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i tij gjegjësisht nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm i IKAPI-it, është vlerësuar me notë të përgjithshme një pikë shtatë (1.7).

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022 pretendon se i njëjti i ka arritur të gjitha objektivat e punës, ndërsa udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë me rastin e vlerësimit të ka zbatuar gabimisht dispozitat e nenit 7 paragrafi 1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik si dhe dispozitat e nenit 43 paragrafi 6, 8 dhe 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Tutje, nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se me datë 18.02.2023 janë përcaktuar objektivat e planifikuara të punës për vitin 2022 mirëpo formulari me objektivat e përcaktuara nuk ka qenë i nënshkruar as nga vlerësuesi dh as nga i vlerësuar, nga rrjedh se nuk mund të arrihet në përfundimin e saktë se është përmbushur kriteri lidhur me përcaktimin objektivat dhe aktiviteve sikurse përcaktohet me nenin 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku përcaktohet se: *“Brenda muajit Janar të vitit për të cilin bëhet vlerësimi i rezultateve në punë apo brenda tre (3) muajve të parë të emërimit të nëpunësit, mbikëqyrësi (vlerësuesi) së bashku me nëpunësin (i vlerësuar) përcaktojnë dhe pajtohen me objektivat dhe me planin e aktiviteve për arritjen e objektivave të përcaktuara për vitin për të cilin vlerësohet”*, ngase në mungesë të nënshkrimeve sikurse të ankuesit dhe udhëheqësit të tij të drejtpërdrejtë në vlerësimin e Kolegjit konstatohet fakti se ndërmjet tyre nuk ka pasur pajtueshmëri të plotë rreth objektivave dhe përcaktimit të aktiviteve që duhet ndërmarrë me qëllim të realizimit të objektivave, ndërsa formulari i datës 18.02.2022 ka përmbajtur gjithsejtë pesë (5) objektiva si vijon: 1. *Përgatitja e ndryshimeve të ligjit të IKAP, strukturës së organizmit dhe avancimi i tyre*; 2. *Menaxhimi i Buxhetit , lulumtimi dhe sigurimi i fondeve financiare dhe jo financiare për projektet e IKAP*; 3. *Promovimi i IKAP, rritja e transparencës dhe vlerësimi i shërbimeve*; 4. *Zhvillimi i kapaciteteve të stafit, promovimi i etikes dhe integritetit, si dhe* 5. *Mbështetja logjistike e projekteve, mirëmbajtja e infrastrukturës dhe avancimi i saj*.

Po ashtu, udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit në formularin e vlerësimit të rezultateve të punës i datës 31.01.2023 ka dhënë komentet e tij lidhur me vlerësimin e ankuesit, dhe ndër tjerash përshkrimi i komenteve më shumë ngjason me vërejtje që në kuadër të parimeve të përgjithshëm të shërbimit civil e kanë fuqinë e masës disiplinore, ndërsa në vlerësimin e Kolegji të Këshillit komentet e tilla nuk janë në frymën e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e nenin 8 paragrafi 4 Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku përcaktohet se: *“ Formulari i vlerësimit siç përcaktohet në paragrafin 3 të këtij neni i dërgohet nëpunësit, i cili diskutohet në një takim me mbikëqyrësin dhe në afat prej 5 dite kalendarike nëpunësi duhet të shprehet (pajtohet ose nuk pajtohet) me vlerësimin e mbikëqyrësit”*, ndërsa nga shkresat e dërguara përmes e-mailit nga Udhëheqësit të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të datës 29.03.2023 si dhe shkresës së datës 24.03.2023 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm i IKAPI-it nuk kanë arritur ta dëshmojnë se udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit ka vepruar në këtë mënyrë duke e njoftuar ankuesin me vlerësimin të paktën 5 ditë përpara se të përfundojë afati i fundit për vlerësime, afat i cili sipas nenit 8 paragrafi 2 të së njëjtës rregullore është i përcaktuar si vijon: *“ Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit*

dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin paraprak”, prandaj një veprim i tillë bie ndesh edhe me nenin 43 paragrafi 8 dhe 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “7. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë harton një raport vlerësimi. 8. Raporti i jepet punonjësit dhe ai diskutohet në një intervistë me të. 9. Pas intervistës, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë miraton raportin përfundimtar të vlerësimit”.

Me qëllim të analizimit të arritjes së objektivave të punës nga ana e ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar Raportin e DFSHP-së së Institutit të Kosovës për Administratë Publike për Periudhën janar-dhjetor 2022 të ofruara në cilësi të provës materiale nga institucioni punëdhënës sikurse ka analizuar edhe Raportin e të arriturave kryesore për vitin 2022 dhe Objektivat e Planit të punës për vitin 2023 i datës 05.01.2023, dhe ka gjetur se në përmbajtjen e tyre nuk ka të evidentuara objektiva të perealizuara sikurse që ishin përcaktuar përveç sfidave të evidentuara në faqen katër (4) si në vijim: 1. Sigurimi i cilësisë së shërbimit të trajnimit; 2. Përgatitja e dokumenteve në zbatim të reformave të brendshme; 3. Implementimi i trajnimeve virtuale krahas metodave tradicionale të trajnimit dhe 4. Zhvillimi i kapaciteteve të stafit për ndryshimet e reja dhe kapaciteteve të infrastrukturës së brendshme, mirëpo nuk pasur indikator të përcaktuar të cilët janë paraqitur në cilësi të sfidës.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka analizuar edhe përmbajtjen e Raportit mujor të punës për agjencitë i datës 09.02.2022, Raportit mujor të punës për agjencitë i datës 08.03.2022, Raportit mujor të punës për agjencitë i datës 09.02.2022, Raportit mujor të punës për agjencitë i datës 08.04.2022, Raportit mujor të punës për agjencitë i datës 10.05.2022, Raportit mujor të punës për agjencitë i datës 10.06.2022, Raportit mujor të punës për agjencitë i datës 10.07.2022, Raportit mujor të punës për agjencitë i datës 10.08.2022, Raportit mujor të punës për agjencitë i datës 12.09.2022, Raportit mujor të punës për agjencitë i datës 11.10.2022, Raportit mujor të punës për agjencitë i datës 13.11.2022, Raportit mujor të punës për agjencitë i datës 11.01.2023, Raportit mujor të punës për agjencitë i datës 11.01.2023 Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të IKAP-it, dhe nga përmbajtje e tyre arrihet në konstatimin e progresit të përgjithshëm të arritur në kuadër të institucionit, ndërsa është për tu theksuar se në kuadër të këtyre raporteve figurojnë si të arritura edhe objektiva dhe aktivitetet të tjera të ndërmarra që lidhen me objektivat e punës së ankuesit sipas formularit të datës 18.02.2022, prandaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se vlerësimi i ankuesit me notën e përgjithshme mesatare një pikë shtatë (1.7) është kundërthënëse me të arriturat dhe progresin e përgjithshëm të paraqitur nga institucioni, ngase nota e vlerësimit (1.7) në kuptim të nenit Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 ku përcaktohet se: “Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: nga 1.5 deri më pak se 2.5 nënkupton “kënaqshëm ose mjaftueshëm”; ” ndërlidhur me paragrafin 2 nën paragrafin 2.4 i të njëjtit nen dhe rregullore ku përcaktohet se: “ Kuptimi i notave si në paragrafin 1 të këtij neni është si në vijim: “kënaqshëm ose mjaftueshëm”, vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar vetëm disa nga objektivat e punës dhe ka treguar aftësi nën pritjet. Kontributi i tij nuk ka ndikuar, ose ka ndikuar vetëm pjesërisht në realizimin e objektivave dhe performancën e përgjithshme të institucionit”, prandaj nëse objektivat dhe aktivitet e përcaktuara si objektiva të punës për vitin 2022 të ankuesit janë të inkuorporuar si progres i përgjithshëm i institucionit, atëherë vlerësimi me notën 1.7 “kënaqshëm ose mjaftueshëm” nuk është vlerësim real dhe objektiv.

Prandaj, nga se u tha si më lartë nga analizimi i shkresave të lëndës dhe dispozitive, Kolegji i Këshillit arrin në përfundimin se për shkak të shkelje procedurale dhe materiale nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit sikurse është pasqyruar në arsyetimin e këtij vendimi, si dhe duke vlerësuar faktin se ankuesi në vlerësimin paraprak sipas Formularit të vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2021 i datës 27.01.2022 ka qenë i vlerësuar me notë të përgjithshme mesatare **4.4**, prandaj në mbështetje të nenit 13 paragrafi 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik ku përcaktohet se: *“Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pas pranimit të ankesës, në afatin ligjor, vendos duke miratuar apo ndryshuar vlerësimin e mbikëqyrësit (vlerësuesit)”*, që të ndryshoj formularin e vlerësimit të rezultateve të punës së ankuesit, duke vendosur që nota e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2022 të jetë **tre (3)** apo *“mirë”* sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, ngase sipas materialeve të bashkangjitur me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill ankuesi ka argumentuar mjaftueshëm me prova material se ka realizuar objektivat e punës dhe ka treguar gjithashtu aftësi të pritshme të punës.

Prandaj, nga se u tha si më lartë, me qëllim të zbatimit të këtij vendimi, Njësia e Burimeve Njerëzore është e obliguar Vendimin e Këshillit A.nr.428/2023 të datës 07.04.2023 ta vendos në dosjen personale të ankuesit sipas përgjegjësi funksionale që ka në kuptim të dispozitive të ligjit material, pasi që ky vendim e zëvendëson Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë për ankuesin për vitin 2022.

Andaj, theksuar si me sipër, në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër **A.nr.428/2023**

Elakron GASHI


Procesmbajtës

Ardita HAXHNIKAJ-DEMI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të ankuesit
- Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm në Institutin e Kosovës për Administratë Publike
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.